



Primitur / Datedur / Primjen / Prototok / Received / Dated / Received / Dated	29.12.2021	1	viti / god / year
Organ / Njësia / Organ / Jedinstvo / Org / Unit	Hi Prot / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKP/SHK/6394/2021			1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.983/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.3091/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.708/2019 të datës 13.11.2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga "Xhelal Mitrovica", nr.35 Komuna Prishtinë, kundër Komunes së Prishtinës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.708/2019 të datës 13.11.2019, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi ka aplikuar në konkursin e datës 19.07.2019 i shpallur nga Komuna e Prishtinës për pozitën "Bashkëpunëtor për Energjetikë" i pa kënaqur me mos ftesën për intervistë, me datë 10.09.2019 ka parashtruar ankesë në kabinetin e Kryetarit të Komunes së Prishtinës.

I pakënaqur me heshtjen e institucionit ankuesi me datë 13.11.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër prot:5345/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.11.2019, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Prishtinës. Ndërsa Këshilli me datë 24.12.2021 pas tre (3) kërkesave të njëpasnjëshme ka pranuar nga Komuna e Prishtinës përgjigjen në kërkesë me numër protokoll: 6341/2021, së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 16.12.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin



Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 15.11.2021 ka nxjerr Aktvendimin A.nr.3091/19 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.708/2019 të datës 13.11.2019

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5345/ të datës 13.11.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shpalljen Publike të Komunës së Prishtinës të datës 19.07.2021 me numër 14-111/06-174614/19, Kërkesa për aplikim e ankuesit e datës 24.07.2019, Formulari i ankesës së ankuesit i datës 10.09.2019 me ankesën e bashkangjitur, Shkresën e ankuesit të datës 23.07.2019, CV-në e ankuesit me të dhënat personale, Diplomën e datës 24.12.1984 me numër:1897, Shtojcën e Diplomës e datës 05.09.2014, Çertifikatën e trajnimit lëshuar për ankuesin nga USAID, Çertifikatën e datës 20.09.2002, Çertifikatën e datës 28.06.2002, Çertifikatën e datës 26.06.2002, Çertifikatën e datës 12.07.2002, Vërtetimin e datës 15.11.2005, Vërtetimin e datës 25.02.2011, Referencën e datës 03.05.2016, Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit, Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.11.2019, Njoftimin e datës 16.12.2019, E-mailin e datës 18.02.2020, Aktgjykimit A.nr.3091/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 15.11.2021, E-mailin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës i datës 24.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.708/2019 të datës 13.11.2019, të parashtruar nga ankuesi

sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të prova të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesi në bazë të kërkesës së datës 24.07.2019 ka aplikuar në konkursin e datës 19.07.2019 i shpallur nga Komuna e Prishtinës për pozitën “Bashkëpunëtor për Energjetikë”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës nenin 12 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *“Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit”,* ndërsa shpallja publike e Komunës së Prishtinës e datës 19.07.2019 ka qenë e shpallur për plotësimin e pozitave për kryerjen e shërbimeve të veçanta (6 mujore) pozitë në të cilën ka aplikuar edhe ankuesi, andaj mbi këtë bazë siç përcaktohet edhe në dispozitat e përcaktuara si më lartë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës nenin 12 paragrafi 4, marrëdhëniet e tilla të punës nuk hynë në kategorinë e Shërbimit Civil dhe e njëjta rregullohet me Ligjin Nr.04/L-077 për Marrëdhënien e Detyrimeve, ndërsa Këshilli nuk është kompetent për të vlerësuar një procedurë të tillë rekrutimi.

Andaj, bazuar nenin 6 paragrafi 1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat për nëpunësit e Shërbimit Civil dhe kandidatëve që konkurrojnë për pranim në Shërbimin Civil, të përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nen paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Andaj, pas konstatimit se pozita për të cilën ka aplikuar ankuesi nuk ka qenë pozitë e Shërbimit Civil dhe se procedura e rekrutimit sipas shpalljes së datës 19.07.2019 bëhet fjalë për marrëveshje për shërbime të veçanta (6 muaj), Këshilli konstaton se nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit meqenëse i njëjti nuk ka aplikuar për një pozitë që hynë në kategorinë e Shërbimit Civil.



Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.983/2021

Flakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;
- Znj. *Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;*
- Arkivit të KPMSHCK- së;

